



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 6 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 14 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.06/L-092 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 2, nenit 6 paragrafi 3 dhe nenit 8 të Rregullores QRK nr.09/20 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e dytë të rregullt, e mbajtur më datën 28.02.2024, merr këtë:

Vendim preliminar Nr.11/2024/KG

për fillimin e procedurës për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër - lokalet në Suhadoll

Neni 1

MIRATOHET vendimi preliminar me të cilin fillohet procedura për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër prona e mëposhtme e paluajtshme e komunës personave fizikë dhe juridikë:

1. Lokali në Suhadoll, me sipërfaqe të përgjithshme prej 36,5 m², i cili gjendet në parcelën kadastrale nr.305-0 ZK Suhadoll, për ushtrimin e veprimtarisë së marketit.
2. Lokali në Suhadoll, me sipërfaqe të përgjithshme prej 60,6 m², i cili gjendet në parcelën kadastrale nr.305-0 ZK Suhadoll, për ushtrimin e veprimtarisë së objektit hotelierie.

Neni 2

Prona e paluajtshme e komunës jepet në shfrytëzim afatshkurtër, për një periudhë kohore 3-vjeçare, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së përshkruar në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Çmimi fillestar i qirasë së lokaleve nga neni 1 i këtij vendimi do të përcaktohet në përputhje me dispozitat e Rregullores në fuqi nr.01/2021/KG për taksat, tarifat dhe gjobat komunale.

Neni 4

Prona e komunës e përshkruar në nenin 1 të këtij vendimi gjendet në listën e pronës së paluajtshme të komunës të destinuar për dhënien në shfrytëzim në vitin 2024 (Vendimi nr. 57/2023/KG).

Neni 5

Procedura për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër do të kryhet përmes procedurës së ankandit publik që do të zhvillohet nga Komisioni vlerësues, në përputhje me dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.06/L-092 dhe Rregullores QRK nr.09/20 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit



[Signature]

Milan Dimitrijević